


Pertej Fjalës

Revistë Kulturore - Edukative e Përnuajshme

Numri 15 - Gusht 2015



- ▶ Islami dhe parimi i tolerancës fetare
- ▶ Si lindim të barabartë dhe sa ndryshojmë...
- ▶ E Tashmja - E Sotmja - E nesërmja
përmes sfidave, përplasjeve dhe ngritjeve tona



Ti s'ishe sot
në atë dhomëzën e robëruar
nga prania jote e gjithëshme.

Dritarja e shtangur s'bëri zë.
.....dhe rrezja e diellit s'e përtheu heshtjen e idhnuar...

Unë prisja të të shihja
siluetën tënde prej njeriu
prapa perdeve që fshehin
kristalin e lotëve të tu...

lëvizjen e duarve që mundohen të çnyjëzojnë hieroglifet
e kësaj bote të mjerë
por... dita e uritur për ty
më tregoi siluetën e një zgavre...



Përmbajtja

- | | | |
|----|--|------------------------|
| 4 | ▶ Editorial
Pesha e fjalës dhe rëndësia e komunikimit ndërnjerëzor | nga A. Muja |
| 8 | ▶ Thesare
Cilat janë disa prej shenjave të pranimit tek Allahu. | nga U. Fejzullahu |
| 10 | ▶ Perla Islame | nga Dr. S. Zeqiri |
| 13 | ▶ Këndvështrim
Kompensimi i agjërimit dhe agjërimi vullnetar | nga S. Koçi |
| 15 | ▶ Madhështi
Islami dhe parimi i tolerancës fetare | nga I. Maçi |
| 19 | ▶ Esencë
Te shpresosh dhe te besosh | nga K. Ndreu |
| 23 | ▶ Zëri im
Si lindim të barabartë dhe sa ndryshojmë... | nga I. Zejnuni |
| 26 | ▶ DRITare
Pas provimeve | nga O. Heta (Varosi) |
| 28 | ▶ Përreth nje boshti
E Tashmja - E Sotmja - E nesërmja
përmes sfidave, përplasjeve dhe ngritjeve tona | nga E. Durmishaj |
| 34 | ▶ Trokas
Çanta e udhetimit | nga E. Muça |
| 36 | ▶ Vetëm për zemrat
Përse e duam Kurandin? | nga A. Baholli |
| 39 | ▶ Imazh | nga Kryeredaktorja |



DREJTORE EKZEKUTIVE:
SHPRESA BASHA
email: shpresabasha@yahoo.com

Kryeredaktore:
ALBANA MUJA (CIKU)
email: anabla2004@yahoo.fr

Redaktore gjuhësore:
HIBA AGOLLI

Recensues fetar:
AHMED KALAJA

Art grafika:
Studio 7 Production

Boton:
MEWADDAH WE RRAHMAH,
TIRANE, ALBANIA, RRUGA H. HIDRI

*Mirëpresim sugjerimet
tuaja, idetë e opinionet
pranë adresës sonë:*

e-mail: përtëjfjalës@gmail.com
www.pertëjfjales.com

© Të gjitha materialet e botuara
në revistë janë të rezervuara për
botuesin e "Përtej fjalës".

Nuk lejohet përdorimi, riprodhimi
apo publikimi i tyre pa lejen e
botuesit.

KËSHILLI I REDAKSISË:

H. Agolli, redaktore,
Ermira Muca, Mimoza Cota,
Edlira Dyrmishaj

Teuta Zeka, Klotilda Ndreu,
Aurela Basha, Elfa Kodra,
Miranda Qoshja

BASHKËPUNËTORË:

Dr. Anjeza Dishnica,
Dr. Suela Bala,
Orieta Heta, Iris Maçi,

Marsela Tarelli,
Entela Hidri,
Arta Kastrati.

*Pikpamjet e paraqitura në revistë nuk shprehin
domosdoshmërisht pikpamjet e revistës.*



Në jetën e përditshme, personi ndeshet me problematika nga më të ndryshmet, ku njëra prej të cilave është komunikimi dhe etika e komunikimit.

Tema e etikës është trajtuar që në kohët e lashta dhe në mënyrë të veçantë është trajtuar për herë të parë nga Aristoteli (384-322 para Krishtit), në librin e tij "Etika e Nikomakut", në të cilin lidh çështjen e etikës me temën e virtytit. Sigurisht, virtyti ka të bëjë jo vetëm me ligjet e brendshme që e drejtojnë njeriun, por është dhe fryt i zakoneve të kohës, në të cilën jetohet, për të cilën çështja e së mirës dhe e së keqes trajtohet në mënyra të ndryshme sipas traditave; çfarë ka qenë tabu në kohët e hershme, sot mund të jetë diçka fare e zakonshme.

Etika e komunikimit ka të bëjë me mënyrën me të cilën secili prej nesh shprehet. Kur flitet për komunikim, flitet për marrëdhënie mes dy apo më shumë personash dhe komunikimi, për të qenë efikas, kërkon krijimin e një hapësire të përbashkët, pra ka të bëjë me bashkëndarjen e kësaj hapësire, e cila mund të jetë jo vetëm fizike, por mbi të gjitha psikologjike, që përmbledh në vetvete jo vetëm të folurit, por mbi të gjitha, të qenit e një personi.

Etika, në këtë rast, luan një rol të rëndësishëm, ngaqë bëhet motori shtytës i veprimeve, duke u nisur nga vlerat e

Pesha e fjalës & Rëndësia e komunikimit ndërnjerëzor

bashkëndara në shoqëri që duhet të jenë të qëndrueshme për të mirën dhe interesin e të gjithëve. Nga kjo lind rëndësia e përgjegjësimin të njeriut për të tjerët jo vetëm për sa u përket administratave, por edhe njeriut në përgjithësi në ambientin ku jeton. Etika nuk ndahet nga tema e ndjenjës së përgjegjësisë, por mbështetet kryesisht në të.

Ne të gjithë e njohim sentencën biblike: "E para ishte fjala". Kjo fjali ngjan shumë metafiziko-filozofike për vetë madhështinë që përmban si psalmi i parë biblik ndjekur korrektësisht nga ajeti kuranor, i cili me kuptim thotë: "Fjala e mirë është si pema e mirë, e cila rritet dhe sjell frutat e veta e prej saj gëzohen të gjithë etj.

Fjala është vërtet e para, që na gëzon që na dallon prej shumëkujt, na mëshiron na njeh me të tjerët, na bashkon dhe na ndan, na hidhëron e përçan. Fjala është aseti që na u dha ne dhe menaxhimi i drejtë i saj na bën të jemi krenarë për vetet tona e të denjë për Dhuruesin e saj, i cili është vetëm Zoti i Gjithësisë - Dhuruesi i Madh.

Fjala mban peshën e saj, e cila vlerëson e

çmon në tregun komunikativ vlerat tona personale e profesionale. Sot jemi të vetëdijshëm e dëshmitarë të asaj çfarë ndodh apo rrjedh pas një fjale që është thënë e nuk është artikuluar mirë, pas një fjale që është thënë dhe ka goditur rëndë, pas një fjale që është drejtuar ndoshta për tek një person, por që ka shtrembëruar shumë të tjerë. Për vetë rëndësinë e peshën që mban, thotë profeti i Zotit paqja e mëshira e Zotit qofte mbi të, ndodh që një fjalë të birin e Ademit e fut në parajsë dhe ndodh e kundërta - që vetëm një fjalë e hedh të birin e Ademit në ferr edhe pse mund të ketë bërë shumë prej punëve të mira që mund të kenë qënë premtuese për një përfundim të mirë, por fatkeqësisht ka qënë fjalë e rëndë dhe pesha e saj p e n g o n përfundimin e mirë.

Po në këtë paralele, mungesa e një komunikimi të mirë pengon në realizimin me sukses 100 % të arritjeve në një shkollë, punë, ndërmarrje të caktuar, institucion tjetër, administratë etj.

Gjithnjë janë vlerësuar dhe parë me një sy vlerësues menaxherët e projekteve dhe programeve, planeve etj, por menaxherët e fjalëve ku janë ?

A gjejmë sot në tregun e punës të tillë menaxherë? A njohim shumë prej tyre- si mund ta kenë cv-në këta ? - Ku mund ta kenë renditur këtë aset- faktin se përveç profesionit qëndror kanë edhe këtë profesion- si menaxher i mirë i fjalës dhe komunikimit ?- Asnjë të tillë thuajse nuk mund ta gjejmë, të paktën në shoqërinë ku jetojmë.

KOMUNIKIMI PUBLIK

Komunikimi dhe etika e komunikimit janë elemente bazë të një institucioni dhe kryesisht arsimor i cili, për natyrë të tij, ka si mision themelor shërbimin ndaj të tjerëve dhe krijimin e një fryme bashkëpunimi në mënyrë që të kihet rezultat në mbarëvajtjen e procesit mësimor- edukativ e më gjerë.

Shërbimi kalon në mënyrë të domosdoshme nëpërmjet komunikimit, qoftë verbal, por edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, siç është mënyra e paraqitjes nga ana e jashtme, por edhe qëndrimi i brendshëm që secili mban në jetën e përditshme para personave dhe

situatave të ndryshme.

Institucioni është jo vetëm një ent në shërbim të edukimit, por ka kryesisht rolin e një edukatori dhe formatori. Në përmjet mënyrave të ndryshme të komunikimit, institucioni

bashkëndan dhe transmeton mendime, ndjenja dhe mbështetje, në bazë të problematikave dhe kërkesave të ndryshme të nxënësve apo studentëve dhe mbarë komunitetit të gjerë studentë-prindër.

Komunikimi arrin efikasitetin e tij, nëse krijon atë hapësirë të përbashkët që lejon të depërtojnë mesazhet në një klimë marrëdhënieje që kontribuon në krijimin e një konteksti paqësor dhe bashkëpunues. Bashkëndarja e një hapësire të përbashkët arrihet nëse i dilet të kalohet pak në këndvështrimin e tjetrit, në mënyrë që të kuptojmë se si perceptohet realiteti nga të tjerët. Mundësia e të arsyetuarit dhe e të dialoguarit kërkon dëgjim, por edhe



respekt ndaj pozicionit të tjetrit, i cili ushtron jo vetëm një rol, por që zotëron edhe aftësi personale dhe profesionale që, ndoshta, dhe shpeshherë i tejkalojnë edhe kriteret e përgjithshme që ai rol ka.

Institucioni apo administrata, përveç normave ligjore etike të shkruara, zotëron edhe një etikë të pa shkruar që secili person mbart me vete duke u nisur qoftë nga niveli kulturor, profesional por edhe nga konteksti familjar nga i cili vjen. Kjo, si pasojë e bën çështjen etike jo vetëm shumë të larmishme, por edhe nganjëherë të pakuptueshme dhe ndoshta të porealizueshme në të gjitha përmasat e saj. Ndërhyjnë në këtë mes edhe mjetet e shumta të komunikimit që nganjëherë mund të ngadalësojnë procesin e vërtetë të një komunikimi efikas. Ndoshta kjo gjë duket paradoksale por fakti që sot ekziston një nivel komunikimi teknik më i përparuar ofron vazhdimisht një mori informacionesh që e pakësojnë kohën e duhur për të qenë në dispozicion për të dialoguar apo dëgjuar personat përreth.

Bota mes morisë së mjeteve të komunikimit vuan për mungesë marrëdhëniesh të vërteta mes njerëzve. Kjo mund të ndodhë dhe në vetë vendin, ku gjendemi dhe punojmë. Një institucion është një sistem i madh brenda të cilit ekzistojnë nënsisteme, të cilat komunikojnë mes tyre dhe një komunikim i mirë i lejon institucionit të ketë arritje të pritshme si nga vetë institucioni, ashtu edhe nga komuniteti.

Komunikimi dhe metakomunikimi lejon që personat, të cilët banojnë ato hapësira fizike dhe psikologjike të përbashkëta të bëhen lehtësues të dhënies dhe marrjes së informacioneve, në mënyrë jo vetëm mekanike, por duke i pasuruar informacionet me nuanca personalizuese të karakteristikave të personit që i kalojnë apo i marrin informacionet. Metakomunikimi është po aq i rëndësishëm sa dhe komunikimi, duke

pasur parasysh që na bën të kuptojmë edhe atë çfarë nuk shprehet, por që bëhet e dukshme me anë të paraqitjes dhe qëndrimit të personit.

Mungesa e komunikimit apo të metakomunikimit etik bllokton në mënyrë shumë të dëmshme kalimin dhe marrjen e mesazheve mes institucionit dhe komunitetit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është të qenit largpamës për sa u përket teknikave dhe metodave të komunikimit. Është e pamundur të përdorim një të folur modern dhe faktikisht të veprojmë në kundërshtim me atë çfarë teorikisht mbështesim. Risitë që ndeshen në jetën e përditshme jashtë mureve të administratës, duhet të nxisin pozitivisht në ndryshimin edhe rrënjësor, nëse nevojitet, të një sistemi që nuk u përgjigjet më faktikisht dhe realisht nevojave të vazhdueshme që lindin, për shkak të ndryshimit të vazhdueshëm të kontekstit në të cilën jetohej.

Përdorimi vetëm verbal i një komunikimi përparues dhe kohor kërkon në të njëjtën kohë dhe koherencë veprimi duke i krijuar kushtet për realizimin e atyre elementëve që në mënyrë verbale kemi komunikuar. Komunikimi etik i një administrate sjell dhe risi në planin veprues dhe realizues të asaj çfarë është komunikuar nga ana verbale. Të komunikosh nga ana etike me përgjegjësi kërkon jo vetëm taktin e komunikimit, por dije, formim, zgjuarsi dhe kompetenca të tjera.

E gjithë bota rreth komunikimit nuk do mbarte rëndësinë e duhur nëse nuk do e trajtonim nën dritën e shkrimeve të shenjta e nën e hijen e thënieve profetike e kjo pasi ato janë të vërteta të qarta që jua tejkalojnë çdo ndërmarrje njerëzore teorie apo praktike, me të cilat operojmë ne sot.

Vetë profeti i Zotit tek i këshillonte ndjekësit e tij besimtarë u thoshte: kur të flisni, flisni me butësi, transmetoni

dashuri dhe shprehjani njerëzve këtë. (me kuptim)

Për të kaluar tek në një thënie profetike : " Kur të flasësh, flit të vërtetën ose hesht". I garantoj një shtëpi në xhenet atij, i cili i lë polemikat në një tubim edhe nëse ai ka të drejtë mbi një çështje të caktuar, por i shmanget zënkave vetëm për hir të Zotit dhe jo si pasjë e ndonjë dobësie".

Kjo shpesh mund të merret si dobësi nga pala tjetër, por ne na mjafton e vërteta e Zotit, i cili i ngre ata që dinë të falin dhe ul përjetë ata që dinë vetëm të ulin.

I garantoj një shtëpi në xhenet atij, i cili kur ligjëron e lë gënjeshtren dhe mashtrimin, përgojimin, bartjen e fjalëve dhe shtrembërimin e tyre.

Ka thënë profeti në një hadith: është quajtur gënjeshtar ai, i cili dëgjon diçka nga dikush tjetër dhe e transmeton atë çfarë ka dëgjuar qoftë edhe pa shtuar asgjë prej saj, e çfarë ngelet të thuhet nëse transmeton diçka tjetër që nuk është thënë?

Gënjeshtria si gjynah prej gjynaheve të mëdha. Prej çështjeve të tjera në komunikim është edhe lënia e ironisë e

skepticizmit dhe talljes gjatë komunikimit pasi e ka humbur Zoti i Madhëruar Atë që tall të tjerët dhe i përqesh ata."

Çdo kohë kur flitet për etikën e komunikimit, mbarë bota e besimit e një thënien plot kuptim si devisën që duhet ta kemi parasysh secili nga ne dhe ajo është: **FJALA E MIRE ËSHTË SADAKA**, dhe kur dijetarët e kanë komentuar këtë hadith kanë thënë se sadaka - është investim për shpirtin, për trupin fizik dhe metafizik si edhe më e rëndësishmja shton ose rrit jetëgjatësinë e njeriut.

Kush prej nesh nuk do ta donte kryesisht këtë të fundit?- Sa prej nesh duam që të jetojmë sa më gjatë, sa më larg vdekjes e sa më larg e më larg - e pra kjo vjen si rezultat i menaxhimit të fjalës së mirë, nëse me të afrojmë e jo largojmë, nëse më të dashurojmë e nuk lëndojmë.

Patjeter që ajo që shton jetët tona, i bën të gjata e të begata është fjala e mirë - e cila po të thuhet shumë shpesh është si të kesh dhënë lëmshë po aq shpesh, është sikur të rritesh e të gezohesh në jetë po aq shpesh dhe sikur tu largohesh brengave të jetës po aq larg.



Cilat janë disa prej shenjave të pranimit tek Allahu.

Njerëzit priren për të fshehtën dhe dëshira për të mësuar atë që nuk e dinë është e madhe. Studenti, posa del nga provimi, kërkon rezultatin menjëherë. Natyrshëm, çdo besimtar pas muajit Ramazan dëshiron të dijë a është në listën e të pranuarve.

Atëherë si ta di unë nëse vërtet jam i pranuar?

Përgjigja e thjeshtë dhe e lehtë do të ishte kjo:

1. Kur besimtari e gjen zemrën më afër Zotit të Lartësuar, e do Atë, ky është fryt i adhurimit dhe shenjë e pranimit.

2. Të dojë adhurimet (ibadetet) dhe ta ndiejë se dyert e adhurimeve janë hapur, kurse ato të mëkateve janë mbyllur.

3. Mos t'i lërë veprat e mira që ka bërë gjatë Ramazanit dhe gjithashtu t'i shtojë veprat e tjera që nuk i ka vepruar gjatë tij.

4. Mos t'i kthehet mëkatit prej të cilit është penduar gjatë Ramazanit.

5. Të përjetojë mirësitë.

6. Të agjërojë gjashtë ditët e Sheualit.

7. Të shpejtojë dhe garojë në vepra të mira.

8. Të jetë pas Ramazanit më i mirë se para tij, të ndiejë se ka një zemër të re që pulson me dashuri për Allahun, me namaz, përkujtim, falënderim.

Këto janë disa prej shenjave të pranimit tek Allahu.

Mos i prish dhe mos i humb veprat pas suksesit. Të gjitha adhurimet e bëra gjatë Ramazanit besimtari mund t'i humbasë me lehtësi nëse nuk i ruan. Sigurisht që veprat e mira duhet të ruhen. Ruajta e veprave arrihet:

Së pari: Kujdes nga tregimi dhe ekspozimi

i adhurimeve

Duhet ta shohësh veten më të vogël se vëllezërit e tu dhe me më shumë mëkate e të meta se ata. Nuk është e drejtë e besimtarit të japë një gjykim mbi veprën e vet, por as të presë gjykimin e të tjerëve mbi adhurimet.

Mos të të duket vetja se ke bërë me këtë vepër diçka, por ta shohësh veprën vetëm si mirësi dhe dhuratë nga Allahu, vepër që m e r i t o n falënderim tjetër, përpjeke të vazhdueshme dhe angazhim shtesë deri në vdekje.

Së dyti: Kujdes nga vetëpëlqimi
Individi duhet të jetë i kujdesshëm nga sëmundja e mendjemadhësisë dhe e egos. Me punët e mira të realizuara nuk duhet t'i pëlqejë vetja, por të ndiejë mangësi në vetvete, duke e parë veten të rrethuar me begatitë e Allahut e jo duke parë veprën e vet.

Së treti: Kujdes nga mashtrimi
Pas kryerjes së veprës njeriu nuk

duhet të mashtrohet duke menduar se është munduar dhe ka fituar. Çdo mund dhe arritje është mirësi e Allahut, dhuratë e Tij. Çdo gjë i atribuohet Krijuesit, absolutisht asgjë njeriut.

Së katërti: Vazhdimësia e veprave të mira
Besimtari patjetër duhet të vazhdojë së vepruari. Pas Ramazanit adhurimet duhen vazhduar dhe shejtani nuk duhet lejuar që të ndikojë dhe të pengojë agjërimin, namazin dhe leximin e Kuranit.

Së pesti: Duke kërkuar ndihmën e Allahut për pengimin e preokupimeve të jetës
Me veprat e bëra që keni realizuar me

ndihmën e Allahut duhet të ruheni nga mashtrimet e shejtanit. I mallkuari shton preokupime, shqetësime, vendos pengesa, por gjithsesi ju duhet të kërkonit ndihmën e Allahut të Lartësuar për fuqi. Nëse nuk ndodh kjo, atëherë do të shkëputeni nga punët e mira, çka do të thotë se njeriu kthehet në gjendjen e mëparshme.

Dijeni dhe mësojeni se:

- rehatia nuk arrihet me rehati;
- çështjet e larta nuk realizohen me dembeli;
- kush mbjell, korr;
- kush mundohet, gjen.



“Tre janë lutjet që pranohen nga Allahu.

- Lutja e atij që i është bërë padrejtësi.
- Lutja e prindit për fëmijën e tij.
- Lutja e udhëtarit”.

Profeti (sal- Allahu alejhi ve selam) thotë: “Më i miri prej jush është ai, i cili sillet më mirë me gruan e tij. Unë jam më i miri ndër ju, në aspektin e sjelljes së mirë me gruan time”.

“Nuk sillet mirë me gruan, veçse i ligu . Dhe, nuk e poshtëron gruan veçse fisniku”.

“Unë Profeti juaj, jua ndaloj kategorikisht shkeljen e të drejtave të të dy të dobtëve: të jetimit dhe të gruas”.

Me të vërtetë gratë janë ana tjetër e medaljes së burrave, e përbëjnë gjysmën tjetër të mashkullit, e plotësojnë atë. Tradhëtia bashkëshortore është një ndër mëkatet më të mëdha që ndëshkohet rëndë. Profeti ynë (sal- Allahu alejhi ve selam) ka thënë: “A doni t’ju tregoj se cila është pasuria më e madhe e njeriut? Ajo është bashkëshortja e mirë: të cilën kur e shikon, të gëzon; kur largohesh prej saj nuk të tradhëton dhe kur e urdhëron, të respekton”.

Gruaja duhet të sillet me bashkëshortin gjithmonë në mënyrë korrekte; ta përcjellë për në punë dhe ta mirëpresë me nderim e respekt; të përpiqet kurdoherë të fusë gëzim në zemrën e tij.

Allahu i Lartmadhëruar në Kuran në suren “En-Nur” thotë: “Thuaju besimtarëve ulni shikimet dhe të ruajnë nderin e tyre”.

Profeti (sal- Allahu alejhi ue selam) kur u njoftua nga një i ri që u fejuar, i tha atij: “Shko dhe shikoje sepse kjo do ta bëjë më jetëgjatë dashurinë mes jush”.

Zoti në Kuran thotë: “Ai krijoi nga vetë lloji juaj gratë në mënyrë që të gjeni tek ato prehje dhe mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë”.

Burrrat dhe gratë janë të barabartë në të drejtat dhe detyrimet që kanë ndaj njëri-tjetrit. Burrave u takon përgjegjësia e përkujdesjes ndaj grave.

Profeti (sal- Allahu alejhi ve selam) në haxhin e lamtumirës tha: “Përsa i përket grave tuaja; ju keni të drejta mbi to dhe ato kanë të drejta mbi ju. Ju porosis që të jeni të kujdesshëm në sjelljen me to, sepse ato janë nën është peng i veprës së vet”. Prandaj Zoti iu pergjigj lutjes se tyre dhe u tha: “Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush; mashkull apo femër qoftë. Ju jeni njëlloj në shpërblim.(në të drejta e detyrime)”.

“Kush përkujdeset për rritjen dhe edukimin e dy vajzave derisa ato të arrijnë moshën madhorë; ai dhe unë do të jemi në Ditën e Gjykimit kështu (kaq pranë duke i ngritur dhe mbajtur pranë njëri-tjetrit dy gishtat: – gishtin tregues dhe ate të mesit).”

E drejta e femrave për të kërkuar dituri nuk ndryshon nga ajo e meshkujve. Kërkimi i diturisë është obligim për të dyja

gjinitë. Kur Allahu thotë: “Dhe, ato (gratë) kanë të drejta si të burrave dhe burrat janë disa gradë mbi to”. Ky gradim ka për qëllim përkujdesjen dhe mbrojtjen e grave. Kjo i referohet ndryshimeve të natyrshme që ka midis dy gjinive. Logjikisht një gjini që është më e dobët duhet mbrojtur. Kjo nuk nënkupton superioritetin e burrit apo privilegjimin e tij përpara ligjit.

Burri ka rolin drejtues në familje. Por, me këtë rol nuk duhet abuzuar që burri të sillet me arrogancë në familjen e tij. Burri konkludohet me gruan në vendimet familjare të përbashkëta që ata marrin për mirëfunksionimin e këtij institucioni të rëndësishëm.

Allahu e krijon njeriun në barkun e nënës. Pastaj e sjell në jetë duke i futur shpirtin. “Allahu dërgon një engjell, i cili fryn shpirtin e fëmijës në barkun e nënës në ditën e 120 dhe urdhërohet të shkruajë katër gjëra:

1. Rizkun e tij.
2. Sa do të jetojë.
3. Punët që do të kryejë dhe
4. A do të jetë i/e lumtur apo i/e mjerë?”

Allahu e ka shkruar fatin e krijesave të Tij 50 000 vjet para se të krijoheshin Qiejt dhe Toka. Ajo që ka caktuar Allahu do të ndodhë patjetër. Njeriu nuk mund t’i ikë caktimit të Zotit. Muslimani nuk duhet të jetë frikacak dhe t’i shmanget vështirësive. Vdekja i vjen njeriut edhe sikur të jetë brenda në shtëpinë e tij. Kur ajo është caktuar do të vijë edhe po të jetë i shtrirë në shtratin e vet. Prandaj, ai duhet të jetë trim e i guximshëm, ngase e mira dhe e keqja janë në dorë të Allahut. Kështu që atij nuk do t’i ndodhë gjë tjetër, përveçse ajo që është caktuar nga Allahu. Mirëpo, kjo trimëri duhet të ketë kufijtë e saj dhe njëkohësisht duhet të jetë në kuadrin e kriterëve të përcaktuara në Islam.

Bëni durim deri sa të shkoni tek Krijuesi juaj, sepse sa më shumë afrohet Dita e

Fundit (e përmbysjes së botës) aq më shumë shtohen vështirësitë për besimtarin; çdo kohë që vjen është më e vështirë se ajo që ka kaluar.

Në Ditën e Kiametit të parët bëjnë shefaet (ndërmjetësim) Pejgamberët, pastaj dijetarët dhe pastaj shehidët.

Jeta e kësaj bote i ngjan një ure që duhet kaluar. Mos u jepni tërësisht pas kësaj bote e të harroni botën tjetër. Mos u mundoni të rregulloni urën, por kalojeni menjëherë dhe ikni pa u ndalur.

Po qe se zemra është e pastër, atëherë edhe goja nxjerr fjalë të mira.

Veprat më të dashura tek Allahu janë:

- Namazi i falur në kohën e vet.
- Sjellja e mirë me nënën dhe babain.
- Ushqyerja e të varfërve.
- Falja e namazit të natës kur njerëzit janë në gjumë.
- Moslëndimi i njerëzve as me dorë dhe as me gjuhë.
- Përpjekja në rrugë të Allahut.
- Haxhi ‘mebrur’(i saktë, pa bërë kurrfarë gjynahu në të).
- Përmendja e vazhdueshme e Allahut.
- Puna e vazhdueshme dhe konstante.

Ne qoftë se doni të vazhdoni të jetoni edhe pasi të keni shkuar në botën tjetër lini prapa vepra të pavdekshme.

“Muslimani që viziton të sëmurin, gjatë vizitës mbledh dhe grumbullon frutat e Xhenetit”.

“Ai që nuk falenderon njerëzit, nuk ka falenderuar Allahun”.



- Trupi gjen rehati po të ushqehet me pakicë. Ndërsa shpirti gjen prehje e rehati, po të bëjë sa më pak e më pak gjynahe.

- Kush fal shumë namaz gjatë natës i zbukurohet fytyra ditën.

Cili është ibadeti më i mirë?

Të kryesh farzet dhe të ruhesh nga haramet.

Cila është sadakaja më e mirë?

Është ajo që jepet më dëshirë kur ke pak pasuri.

Cila është fjala e drejtë?

T'i tregosh gabimet atij që ka gabuar,

burg, ndërsa me Xhehenemin është si Xhenet.

Zekati i shtëpisë është që brenda saj të ketë një dhomë për miqtë. Stomaku është depo e të gjitha sëmudjeve, ndërsa agjërimi është kreu i çdo ilaçi.

Dy gjëra i dëshironi, po nuk i gjeni dot: lumturia dhe rehatia. Ato gjenden vetëm në Xhenet.

“Kush e beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit le të nderojë mikun e vet”.

Mikpritja është detyrë për muslimanët. Afati i saj është tre ditë dhe tre netë. Nëse

miku qëndron më shumë se tre ditë dhe tre netë nuk është obligim mikpritja, por konsiderohet si sadaka.

“Nuk është i fortë ai që përdor fuqinë trupore për të mundur të tjerët, por ai që e kontrollon veten kur zemrohet”.

Të durosh do të thotë ta mbash dhimbjen brenda vetes pa e shfaqur në fytyrë.

“Ai, në zemrën e të cilit ka mendjemadhësi sa një grimcë, nuk do të futet në Xhenet”.

Njeriut që i është dhënë butësia i janë

dhënë të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Merrni nga kjo botë atë ç'ka ju duhet në Ditën e Kijametit (veprat e mira).

Durimi është një nga disiplinat më të rëndësishme të fesë sonë. Sprova e durimit është një nga sprovat më të vështira. Për këtë arsye, Ebu Bekri ka thënë: “Është më lehtë të jem mirë dhe të falenderoj, se sa të sprovohem dhe të duroj”.

Kompensimi i agjërimit dhe agjërimi vullnetar

KENDVESHTRIM

Kush e çel agjërimin në Ramazan për ndonjë shkak të lejuar, si udhëtimi ose sëmudja etj, apo për shkak të ndaluar, si ai që ha ose pi qëllimisht, ose bën marrëdhënie intime gjatë ditës së Ramazanit, ai duhet të kompensojë po aq ditë sa nuk ka agjëruar. Për të është e preferuar të shpejtojë në kompensimin e atyre ditëve që i kaluan nga agjërimi, në mënyrë që ta largojë përgjegjësinë dhe nuk i lejohet ta vonojë kompensimin pa kurrfarë arsye derisa të vijë muaji i Ramazanit të vitit tjetër.

Ai që nuk agjëron për shkak të pleqërisë ose sëmudjes dhe nuk shpreson që të shërohet kjo sëmudje

Nëse muslimani është i moshuar dhe nuk mund të agjërojë, ose është i sëmurë me ndonjë sëmudje që nuk shpresohet shërimi i saj, kësaj kategorie Allahu i ka lehtësuar duke iu obliguar atyre në vend të agjërimit ushqimin e një të varfëri për çdo ditë nga gjysmë sa'i (1,40) kg. nga ushqimi i vendit.

Gruaja shtatzënë dhe ajo që ushqen me gji Nëse gruaja shtatzënë apo ajo që ushqen me gji, frikësohet për vetën ose për

fëmijën e saj se agjërimi do ta dëmtojë ate ose fëmijën e saj, dhe kjo frikë është reale, jo e supozuar, atëherë asaj i lejohet të hajë, pra të mos agjërojë dhe pastaj duhet t'i kompensojë vetëm ato ditë.

Agjërimi vullnetar

Allahu i Lartësuar ka miratuar agjërimin e ditëve jashtë muajit të Ramazanit. Atë nuk ua ka obliguar muslimanëve, por e ka bërë të preferuar, me të plotëson defektet që ndodhin në agjërimin e obliguar dhe për të ka përcaktuar shpërblim të madh. Prej këtij agjërimi është:

1. Agjërimi i gjashtë ditëve nga muaji Sheual, muaji që pason muajin Ramazan . I Dërguari, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: “Kush e agjëron Ramazanin dhe pas tij agjëron gjashtë (ditë) nga Shevali, është sikur të agjërojë tërë kohën”.

2. Agjërimi i ditës së Arafatit (ajo është dita e nëntë e muajit Dhul-hixhe). I Dërguari, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: “Agjërimi i ditës së Arafatit i shlyen (gjunahet e vogla) të vitit të kaluar dhe të vitit të ardhshëm”.



megjithëse ai mund të jetë i fuqishëm.

Kush quhet njeri i mençur?

Ai që bën vepra të mira dhe këshillon të tjerët të bëjnë vepra të mira.

Kush quhet i paditur?

Ata që vlerësojnë këtë botë më shumë se botën tjetër.

Tre gjëra e vdesin zemrën: Të folurit e tepërt, të fjeturit e tepërt dhe të ngrënit e tepërt.

Kjo botë në krahasim me Xhenetin është si



3. Agjërimi i Ashurasë (ajo është dita e dhjetë e muajit Muharrem). I Dërguari, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: “Agjërimi i Ashurasë shpresoj tek Allahu t’i shlyejë (gjunahet e vogla) të vitit të kaluar”. Më e vlefshme është që së bashku me të, të agjërojë edhe një ditë para ose pas saj.

Si dhe agjërimet e tjera vullnetare. I Dërguari, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: “Çdo rob që agjëron një ditë në rrugë të Allahut, Allahu me atë ditë fytyrën e tij e largon nga zjarri shtatëdhjetë vjet”.

Agjërimi i ndaluar

I Dërguari, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka ndaluar agjërimin e ditës së dyshimit. Ajo është dita e tridhjetë e muajit Sha’ban, agjërimin e ditës së Fitër Bajramit ose të Kurban Bajramit, agjërimin e tri ditëve të Kurban Bajramit, ato janë dita e njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë nga muaji Dhul-hixhe, përveç atij që është duke kryer haxhin dhe duhet të prejë kurban të Haxhit, mirëpo nuk mund ta gjejë atë (atij i lejohet agjërimi i këtyre tri ditëve). Sikurse që është i urryer veçimi i ditës së premtë me agjërim, përveç nëse ajo përputhet me agjërim të miratuar, si p.sh. dita e Arafatit, ose së bashku me të (me të premtën) të agjërojë edhe ditën e enjte ose të shtunën, atëherë agjërimi i saj nuk është i urryer.

Përgatiti: Shpresa Koçi



ISLAMI DHE PARIMI I TOLERANCËS FETARE

MADHESHTI

Toleranca fetare ka forma të ndryshme të të kuptuarit, por kuptimi themelor dhe bazë e saj është fryma e dialogut në islam.

Toleranca, bashkëjetesa, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi janë terma dhe shprehje që të gjitha lidhen me thirrjen e pastër islame (da’ea), me gjetjen e rrugëve të dialogut me të tjerët në bazë të kushteve dhe rregullave të vendosura më parë.

E nëse toleranca në vetvete, konsiderohet karakteristikë e veçantë që e zbaton shoqëria e cila thërret në islam, atëherë toleranca me të tjerët, pra me përkrahësit e feve të tjera, përbën një rol të veçantë, ku në thelb ka lirinë fetare, që konsiston parimin se feja është besim, doktrinë, përmbushje e plotësim i shprehjes “ Nuk ka dhunë në fe” (Bekare / 256).

Nëse islami është fe e tolerancës me veten dhe me të tjerët, atëherë, kjo nuk mund të vërtetohet dhe praktikohet veçse me anë të zbatimit të drejtë të parimeve islame dhe përçimin më tej të tyre.

Dhe janë po vetë ata (muslimanët) përgjegjës, për paraqitjen dhe vërtetësinë e shembujve të shumtë mbi islamin e parimet të tij.

Për gjatë gjithë historisë, muslimanët kanë qenë mbrojtës të parimit të tolerancës fetare, kjo nëpërmjet rrugëve të bashkëekzistencës, dialogut me të tjerët, duke e konsideruar tolerancën si shprehjen më përmbledhëse dhe si kulm të civilizimit. Në islam, vlera më e madhe buron nga ‘ toleranca ’ me kuptimin e saj gjithëpërfshirës, e cila praktikohet në të gjitha fushat si sociale, morale, ligjore etj. Në shoqërinë ku praktikohet ky parim nuk

ka vend për intolerancë, fanatizëm të tepruar, ekstremizëm apo edhe nga çdo dhunë apo skajshmëri të tepruar qoftë me veten apo me të tjerët.

Ndërsa sot, nën ombrellën e shpërthimit të luftrave e konflikteve të ndryshme dhe reagimeve të civilizuara që po ndodh ndërmjet popujve dhe shteteve, kërkohet me këmbëngulje të madhe nga muslimanët që të shpalosin bazat e këtij parimi, të kësaj tolerance me të tjerët, me qëllim ndryshimin e imazhit të deformuar, imazh të cilin perëndimi vazhdon t’a shpërftyrojë e t’i japë formën që i intereson.

Parimi i tolerancës fetare në islam është një çështje e përcaktuar si në Kur’an ashtu edhe në traditën profetike dhe përpjekja e mospranimit, përgënjeshtimit, mohimit të akuzave që i bëhen islamit, si fe e dhunës dhe e terrorizmit, nuk duket si një gjë e pëlqyeshme apo e pranueshme nga perëndimorët, e këto përpjekje bëhen për të vetmen arsye, për t’ua provuar atyre se në Kur’anin tonë të shenjtë nuk ka siç pretendojnë ata – se që nga themeli apo baza e kësaj feje, ajo përmban dhunën dhe intolerancën - por e kundërta është e vërtetë, ajo përmban dialogun, paqen e bashkëjetësën.

Për rrjedhojë, përgjegjësia kryesore i takon atyre (muslimanëve) që kanë forcën mendore dhe intelektuale për të sqaruar të vërtetat e padiskutueshme të kësaj feje paqedashëse, tolerante etj... nëpërmjet sjelljeve të tyre, moralit, bashkëpunimit me të tjerët nën frymën e tolerancës islame dhe forcës së paqes.

Çdo dhunë apo terror që ndodh në botë,

Ja disa citate kur'anore ku shihet qëndrimi pozitiv i islamit në tolerancë, mirëkuptim etj...

- Islami mohon dhunën në fe, këtë e shohim qartë në Kur'anin e shenjtë “ Nuk ka dhunë në fe.” (Bekare / 256). Duke qenë se islami është fe e kompletuar dhe e bekuar nga vetë Zoti i Madhërisëm për robërit e Tij, e në të njejtën kohë i Madhërismi nuk ka dashur që ky besim të ishte i ngritur mbi dhunën, imponimin, detyrimin me forcë, kjo me qëllim që robi i Tij t'a përqafojë këtë fe me dëshirën dhe pëlqimin e tij të plotë. Muslimanët thërrasin në fenë e tyre me urtësi, tolerancë e me një gjuhë të mirë komunikimi, me dialog ku sillen argumenta llogjike dhe faktike, e për më tepër duke u larguar nga mënyrat e ndërlikuara, të imponuara, të detyruara apo qoftë edhe të ashpëra. Këtë gjë e ka vërtetuar edhe historia kur flet mbi përhapjen e Islamit në botë.

Një dijetar francez Gustav Lupon ka shkruajtur në librin e tij “ Civilizimi Arab”, ai tregon mbi përhapjen dhe shtrirjen e muslimanëve në troje të tjera si dhe mënyrat që ata kanë përdorur për të përhapur fjalën e Zotit (Kuranin), e kjo duke i lënë të lirë të tjerët në besimin dhe fenë e tyre. Edhe nëse kishte ndonjë që kish pranuar islamin dhe gjuhën e tij, këtë e ka bërë sepse ata panë tek ata (muslimanët) drejtësinë, gjë të cilën nuk e kishin parë më parë tek udhëheqësit a zotëritë e tyre, gjithashtu ata panë tolerancën gjë të cilën nuk e kishin njohur më parë. Islami nuk është përhapur me shtatë por me daëa, predikim ...- thotë ai.

Predikimi apo thirrja në fe, jo nëpërmjet agresionit, pushtimit. Allahu thotë në Kur'anin e shenjtë : “Mos sulmoni. Me të vërtetë Zoti nuk i don agresorët” (Bekare/ 190). Armiqësia qoftë personale apo në grup, përbën një krim të pastër. Allahu thotë në Kur'an: “Kush vret një njeri, i cili nuk ka vrarë apo ka bërë shkatërim në tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit...” (Surja Maide / 32). Islami i trajton kundërshtarët e tij me tolerancë, derisa ata nuk i dhunojnë apo vrasin. “ E nëse ju sulmojnë, atëherë sulmohuni edhe ju ata” (Surja Bekare / 191) Përkrahja dhe inkurajimi ndaj jomuslimanëve dhe trajtimi në mënyrë të mirë i tyre. Këtë e vërtetojnë fjalët e Zotit ku thotë në Kur'an: “Allahu nuk ju ndalon të bëni

perëndimorët ja mveshin islamit duke i akuzuar muslimanët si të dhunshëm, ekstremistë e më keq akoma si terroristë.

Në të vërtetë islami nuk është fe e tillë, por ajo është fe që thërret në dialog, debat të pastër e të kuptueshëm e tolerant, e për rrjedhojë kjo fe thërret në bashkëjetesë, paqe ndërmjet popujve dhe kombeve. Në Kur'an thuhet : “O ju që keni besuar! Hyni që të gjithë në paqe.” Apo ku Allahu i Lartësuar thotë në një tjetër ajet kur'anor “ Mos sulmoni. Në të vërtetë Allahu nuk i don agresorët.” (Bekare/ 190).

Parimi i tolerancës në islam bazohet në disa themele bazë, që konsiderohen si dëshmi të qarta, kjo për të treguar se sa e lidhur është shpirti i tolerancës në opinionin dhe konceptin e islamit dhe se të gjitha këto e kanë burimin në Kur'an.

mire dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja. Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë.” (Surja Mum'tehine/8). Islami për jomuslimanët që përbëjnë minorancë në shoqërinë islame, përdor frymën e tolerancës, bashkëjetesës e të lirisë së besimit dhe zbatimit të fesë së tyre. Gjithashtu islami nuk lejon që të debatohet me ta, veçse me një mënyrë sa më të mirë komunikimi. A nuk thuhet në Kur'an “ Ju keni fenë tuaj e unë kam fenë time...” (Surja Kafirunë/6)

Përdorimi i shprehjeve kur'anore gjatë bashkëbisedimit me kristianët apo jehudët, e këto shprehje janë ' banorë të librit', ose 'atyre të cilëve u ka zbritur libri', apo si të siguruarit, pra ata të cilët janë nën besë, mbrojtje e siguri etj...Shprehje si këto tregojnë qartë shpirtin e tolerancës, të butësisë, të thirrjes për dialog, mirëkuptim dhe që të gjitha këto të çojnë në forcimin e marrëdhënieve të muslimanëve me të tjerët.

Sigurimi e pranimi i ligjit të ndryshimit, me këtë kuptojmë që gjithçka është ndryshe nga tjetra, hëna, dielli, toka, ndryshojnë, e po të njejtën gjë themi edhe për njerëzit, të cilët ndryshojnë nga njeri – tjetri, si për nga gjinia, ngjyra, gjuha, besimi, intelektu etj..., Ne nuk mund t'a ndryshojmë apo t'a hedhim poshtë këtë ligj të ndryshimit, por përkundrazi ne duhet t'a kuptojmë dhe t'a pranojmë atë. Allahu thotë në Kur'anin e shenjtë: "sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit të një feje. Ata vazhdojnë të jenë të ndryshëm e në kundërshtime (mes vete). Përveç atyre që i ka mëshiruar Zoti yt, e për këtë i ka krijuar" (Hud/118,119), apo kur thotë: "Për secilin prej jush u caktuan ligje e programe. Sikur të donte Allahu do t'ju bënte një popull (në fe e besim), por Ai deshi t'ju sprovtojë..." (Surja Maide/48). Ligji i Zotit në tokë ka të bëjë me ndryshueshmërinë njerëzore e duke u nisur nga kjo edhe islami e ka pranuar këtë ndryshim edhe në aspektin e besimit, kur thotë se nuk ka dhunë apo imponim në besim. Qëllimi i këtij ajeti është për të treguar se nëse do të kishte dashur Zoti do t'i kishte bërë të gjithë njerëzit


të një besimi, niveli, karakteri, pranimi, njohjeje e kuptimi.

Në të vërtetë, vendimi për të pranuar tjetrin me gjithë natyrën e ndryshme që ai ka, qoftë në besim, mendim apo edhe në qëndrimin që mbajnë gjatë dialogut e bashkëbisedimit si dhe në kuptimin e pranimin e mendimit ndryshe e kjo pa imponim. Në këtë aspekt kemi tolerancë dhe jo intolerancë, e të gjitha këto dëshmi të nxjerra nga Kur'ani i shenjtë tregojnë për këtë parim të tolerancës islame përkundrajt feve të tjera, e në të njejtën kohë themi se përgjegjësia kryesore bie mbi muslimanët në mënyrë që t'a zbatojnë këtë parim por edhe t'i nxisin të tjerët për t'a përçarur më tej këtë cilësi deri në respekt e dashamirësi.

Padyshim se parimi i tolerancës qëndron mbi të gjitha parimet e tjera që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet shteteve e popujve, se është toleranca ajo që bën të mundur që të zhvillohen takimet, dialogu, mirëkuptimi, njohja reciproke etj....

Ne, muslimanëve na del për detyrë që t'a ndreqim e korigjojmë pamjen negative që po i mvishet islamit sot, por kjo arrihet duke shfaqur e nxjerre në pah vlerat e tolerancës e të mirëkuptimit sa më mire e sa më natyreshëm ...

Te Shpresosh Te Besosh



“ Thuaj: O robtë e Mi, që e keni ngarkuar veten tuaj me shumë mëkate, mos e humbisni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, sepse vërtet Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai fal shumë, Ai është Mëshirplotë.” (Ez'Zumer 53)

Shpresa kjo fuqi shtytëse që të hap zemrën për të punuar, që është gjëja më e çmuar e jetës, është lehtësuesi i mjerimeve, kërkuesi i gëzimeve dhe lumturive.


Sa e zorshme është jeta në qoftëse nuk ekziston shpresa?

Shpresa është si ajo shija e ëmbël, ajo është bukuria e vetë jetës.

E pra shpresa dhe besimi të dyja këto janë gjëra të domosdoshme për njeriun. Besimtari është ai që ka shpresën më të madhe dhe më të gjërë, sepse Imani ka kuptimin e besimit tek një forcë madhështore që është dhe rregullatori i kësaj gjithësie, e që asgjë e paditur apo e pa mundur nuk ekziston për Të, e Ai është Zoti i Madhërishmi, është Caktuesi, Mëshiruesi, është Ai që i përgjigjet të

shqetësuarit kur ai i lutet Atij, Zbuluesi i të keqes, Falësi i mëkateve, pranuesi i pendimit, Ai është Zoti që është Një, Mëshiruesi ndaj robit të Tij, është më Mëshirues edhe se nëna ndaj djalit të vet. Ai zgjat dorën e Tij natën që të pendohet gabimtari për mëkatet e ditës, e po ashtu zgjat dorën e Tij ditën për t'i falur mëkatet e bëra gjatë natës. Është Ai që gëzohet kur robi i Tij pendohet me sinqeritet e që një të mirë të tij, Ai ja shpërblen me 10 si ato e deri në 700 herë më shumë. Zoti është Ai që i ndryshon ditët me rradhë, e pas frikës i jep sigurinë, e pas dobësisë jep forcën, pas vështirësisë jep shpëtimin, e pas çdo shqetësimi dhe preokupimi jep zgjidhjen, e pas çdo ndërlikimi jep lehtësimin....

Besimtari është ai i cili i mbështetet vetëm Allahut, Mëshiruesit, Bamirësit, Falësit, Atij që ka çdo gjë në dorë e jeton me shpresë e që kjo nuk ka kufi për të. Ai gjithmonë është aktiv e shikon jetën me një fytyrë të qeshur dhe çfarë do që atij i



ndodh nuk i sheh i frikësuar, e në qoftëse lufton është i sigurt në fitore sepse Zoti është me të. “ E tashmë fjala (premtimi) jonë u është dhënë më parë robërve tanë të dërguar, se ata padyshim do të jenë të ndihmuar. Dhe ushtria jonë do të jenë, ata ngadhnjyesit”(Safat 171-173). Edhe në qoftëse ai është i sëmure nuk e humb shpresën për shërim “ Zoti që më krijoi. Ai më udhëzon mua. Dhe Ai që më ushqen dhe më jep të pijë. Dhe kur të sëmurem Ai më shëron” (Shua’ra 78-80). Edhe në qoftëse gabon, ai nuk bie në pesimizëm në pendimin e tij, sepse sado i madh që të jetë gabimi i tij, në qoftëse pendohet me sinqeritet, Allahu është falësi më i madh “ Thuaj: O robët e Mi të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbëni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, se vërtet Allahu i fal të gjitha mëkatet. Është Ai që fal shumë dhe është Mëshirues.” (Zembr 53).

Edhe në qoftëse është në vështirësi ai e di se do të vijë lehtësimi “ Dhe t’i bindet Zotit të tij, ashtu si i takon. “O ti njeri, ti vërtet përpiqesh me një përpjekje të madhe që të çon tek Zoti yt, e atë (përpjekje) do ta gjesh.” (Inshirah 5-6). Edhe në qoftëse do t’i ndodhë ndonjë fatkeqësi, ai e di pas çdo fatkeqësie që atij i bie, Allahu do t’ia kompesojë atij me diçka të mirë “ Të cilët kur i godet ndonjë gjë e pakëndëshme thonë: “Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi. Të tillët janë që tek Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë. ” (Bekare 156-157). Allahu është Ai që ja kthen urrejtjen në dashuri “ Pritet që Allahu të vërë miqësi ndërmjet jush dhe atyre që kishit armiqësi. Allahu është i fuqishëm, Allahu falë mëkatet dhe është Mëshirues.” (Mumtehinë 7). Edhe kur ai e di se po i vjen plakja, po thinjet dhe po e lë këtë botë, shpreson tek bota tjetër, ku do të jetë vetëm i ri dhe ku vdekje nuk do të ketë, por vetëm lumturi. “ Ato janë kopshtet e Adnit, që Mëshiruesi ju pat premtuar robërve të vet, pa i parë ato, e premtimi i Tij është i kryer. Aty nuk dëgjojnë fjalë boshe por vetëm përshëndetje. Aty kanë ushqimin e vet të llojllojshëm mëngjes e mbrëmje” (Merjem 61-62).

Mjaft qartë duket në shëmbullin e Ibrahimit(a.s) që dëshiron të ketë një djalë, por ai është në moshë të madhe(i vjetër) “ Zoti im më dhuro mua një fëmijë prej të mirëve” (Safat 100). Dhe Allahu i përgjigjet, duke dërguar Engjëjt në pamjen e mysafirëve dhe i thonë: “ Mos u frikëso, ne po të paralajmërojmë për një djalë të zgjuar. Ai (Ibrahimi) i tha: A më paralajmëroni mua që më ka kapur pleqëria. E më çfarë po më gëzoni ju? Ata i thanë: Ne po të premtojmë për atë që është i sigurt e ti mos u bë i pashpresë? Ai tha : Askush nuk e humb shpresën në mëshirën e Zotit të vet, përveç atyre që

janë të humbur.” (Hixhër 53-56). E më pas ai e falenderon Allahun për këtë “ Falenderimi i qoftë Allahut i cili në pleqëri më fali mua Ismailin dhe Is’hakun. Vërtet Zoti im dëgjon dhe i përgjigjet lutjes.” (Ibrahim 39).

Apo tek Jakupi (a.s) kur humbi fëmijën e tij Jusufin, e ai nuk e humbi shpresën për t’u takuar me të. “ Durimi i mirë është shpresë që Allahu do të mi sjellë të gjithë. Ai është më i dijsmi, më i urti.” (Jusuf 83).

E kur filloi t’i vinte keq për të birin, fëmijët e tij i thanë: “ Për Allah, t’i vazhdimisht e përkujton Jusufin derisa do të sëmuresh rëndë, e të shkatërrosh. Ai (Jakobi) i tha: Unë hidhërimim tim dhe pikëllimin tim ja parashatroj Allahut, e unë e di për Allahun atë që ju nuk e dini.” (Jusuf 85-86), e më pas ai i tregoi fëmijëve të tij për të vërtetën e asaj që ndjen, dhe besimin që ai ka tek Allahu. “ Jakobi ju tha bijve të vet: O bijt e mi, shkoni dhe kërkoni (në Egjipt) për Jusufin dhe vëllain e tij, e mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut, sepse vetëm populli jo besimtar e humb shpresën tek Allahu.” (Jusuf 87).

Shpresën dhe besimin e shikojmë edhe tek Zekerija(a.s) “ Kur ai i lutet Zotit të tij me një zë të ulët dhe i thotë: Zoti im! Vërtet mua më janë dobësuar eshtrat, e më janë përhapur thinjat në kokë, e me lutjen time ndaj Teje o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar.” (Merjem 3).

Apo tek Ejubi (a.s) “ Përkujto edhe Ejubin kur iu drejtua Zotit të vet me lutje (Më gjeti belaja e Ti je më mëshiruesi ndër mëshiruesit. Ne ju përgjigjëm atij nga mëshira jonë, ia hoqëm vështirësitë që ai kishte, i dhamë familjen e tij dhe aq sa ishin ata, dhe e bëmë përkujtim për të devotshmit .” (Enbija 83-84).

Apo tek Jonuzi (a.s) kur ishte tek barku i balenës “ Përkujto edhe atë të peshkut (Jonuzin) kur doli i hidhëruar (prej popullit) dhe mendoi se nuk do t’i vijë më

puna ngushtë, e në errësirë i tha: Nuk ka Zot përveç Teje. Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejtësi vetes. Dhe Ne iu përgjigjëm atij, e shpëtuan nga tmerri. Kështu i shpëtojmë Ne besimtarët.” (Enbija 87-88).

E ndërsa Musai (a.s) kur nxitonte me popullin e tij për të shpëtuar nga Faraoni dhe ushtria e tij, tha: “ Padyshim me mua është Zoti im. Ai do të më udhëzojë. E ndërsa Ne Musait i thamë: Me shkopin tënd bjeri detit. Deti u nda dhe çdo pjesë e tij u bë si kodër e madhe. E Ne i afuam atje të tjerët (ato të faraonit), dhe Ne e shpëtuan Musain dhe të gjithë ata që ishin me të e ndërsa të tjerët i përmbytëm në ujë. Vërtetë në këtë ngjarje ka fakte, por megjithatë shumica e tyre nuk besuan.” (Shua’ra 60-67).

Apo kur përmendim Muhamedin (a.s) në shpellën e Theurit “ Në mos e ndihmofshin atë(Muhamedin a.s) atë e ka ndihmuar Allahu, kur ata që nuk besuan e nxorrën atë vetë të dytin, e kur të dy ishin në shpellë e ai po i thoshte shokut të tij: Mos u frikëso, Allahu është me ne. Dhe Allahu i zbriti qetësi në shpirtin e tij, e fuqizoi me një ushtri që ju nuk e patë, dhe fjalën e atyre që nuk besuan, e bënë më të ulët. Kurse fjala e Allahut është më e larta. Allahu është më i fuqishmi, më i urti.”

(Teube 40).

Këto janë ngjarje që historia i njeh, e për këto nuk ka dyshim.

Por, shpresa padyshim që ka lidhje me përparimimn e shkencës dhe zhvillimin e saj, se në qoftëse do të kemi shkencë por nuk do të kemi shpikje e zbulime të reja, njeriu nuk do të shikojë vetçe ato ngjarje të vjetra, dhe nuk do të ketë më shpresë në zbulimin e të panjohurës apo të përfitohet nga e reja. Kjo shpresë bëri që njeriu të shkojë në hënë dhe përtej saj.

Shpresa pa tjetër që është e shoqëruar me suksese, e në qoftëse e humb këtë shpresë, njeriu veçse ka hyrë në një luftë pa armë. Si shëmbull kemi jetën e profetit (a.s), qëndroi në Mekë për 13 - vjet duke thirrur popullin në paqe, por shumë pak ishin ata që e përqaftuan atë, të tjerët e quajtën gënjeshtar, mashtrues, fallxhor, talleshin me kur’anin e tij, dhe ai (a.s) arriti deri aty sa i urdhëroi me besim dhe vendosmëri ndjekësit e tij që të emigronin për në Habeshe (Shpërndahuni nëpër tokë sepse Allahu do t’ju mbledhë një ditë juve) etj..etj..

Atëherë si mund t’a quajmë këtë?!Ja, kjo është shpresa, e në qoftëse keni dëshirë quajeni besimi tek ndihma e Zotit. “Ai ndihmon atë që do, dhe Ai është i Gjithfuqishëm, Mëshirues”- (Err’Rrum 5)



SI LINDIM TË BARABARTË DHE SA NDRYSHOJMË...

Luanët ishin absolutisht më të shumtë se lepujt në një “shoqëri” shtazësh. Sigurisht që ishin më të fortë, më guximtarë. Një ditë, kur lepujt kërkuan të drejta të barabarta për të gjithë dhe barazi në fushën e lirive “shtazore”, luanët u përgjigjën: “Ju doni të jeni të barabartë me ne? Po ku i keni kthetrat dhe dhëmbët?”

(Nga një Fabul e Ezopit)

Nocioni i barazisë shtrihet në shekuj, vërtitet përgjatë luftërave të “ftohta” ku mbizotëron vlera, dija, virtyti dhe besimi e nga ana tjetër forca, pushteti dhe pasuria, e ajo që është më e rëndësishmja përpëlitet të ashtuquajturve “qenie”. Historikisht janë ndeshur e përplasur alternativat e mundshme të definicionit të barazisë që qëndrojnë në dy boshte. Boshti i parë konstaton në të parit e barazisë si një hapësirë ku të gjithë individët duhet të kenë mundësi të barabarta në përfitimin e kësaj barazie dhe boshti tjetër konstaton në domosdoshmërinë e të qenit të barabartë. Duhet të dimë se barazia prek të gjitha fushat e jetës, të tilla si: ato ekonomike, politike, shoqërore, etj. Ajo që e dallon një qenie njerëzore nga kafshët është pikërisht intelektit, aftësia për të menduar dhe logjikuar, meqë diversiteti është i pashmangshëm, dhe kjo ka baza natyrore, një individ nga një tjetër e dallon sasia dhe cilësia e intelektit të fituar nga edukimi dhe pastaj ushqyerja e këtij edukimi nëpërmjet përvojës. Në kontekstin e barazisë kjo çështje qëndron në dhënien e të gjitha shanseve dhe mundësive të barabarta për fitimin dhe ushqyerjen e edukimit. Meqë rruga drejt këtyre përvetësimeve nuk është e lehtë, përkundrazi do një stërmundim dhe lodhje të madhe është në të drejtën e tyre shpërblimi në bazë të meritave e aftësive. Ky përbën nocionin e “Drejtësisë” barazia dhe drejtësia janë shumë afër njëra-tjetrës

por mjafton një keqkuptim i vogël që të arrijnë të marrin rolin e dy poleve të kundërta. Drejtësia konstaton në hetimin dhe interpretimin e barazisë. Shoqëria sa vjen dhe është në zhvillim dhe janë të nevojshme personat e duhur për të qenë bashkëudhëtar të këtij zhvillimi. Por të kthehemi më në bazë të temës sonë, me qëllimin që të jemi të mirinformuar për shkaqet që të çojnë në një mosbarazim. Kemi të bëjmë me shkaqet që lindura që shkaktojnë pabarazi të tilla si: jo të aftë fizikisht apo mendërisht, këto shkaqet janë quajtur shkaqet natyrore. Gjithashtu për një nga shkaqet e tjera flitet pikërisht në pjesën e parë të shkrimit, konkretisht për mundësitë që i jepet çdonjërit nga ne për të qenë të barabartë. Dhe shkaku tjetër ka të bëjë me përvetësimin e disa aftësive që bëjnë diferencën dhe janë vatër pabarazie.

Shkaku i parë është një fatkeqësi që nuk është zgjedhja jote dhe mundësitë për të fituar përsëri statusin i barabartë janë të vogla për të mos thënë të pamundura. Shkaqet e tjera janë përgjegjësi e drejtpërdrejt e individit, si fillim e pastaj e të gjithë shoqërisë. Por për t’i shpjeguar më mirë dhe më saktë të sipërpërmendurat, le të japim një shëmbull jetik që besoj se na ka ndodhur të gjithëve. Kur dy pjesëtarë të një grupi punojnë për të njëjtën qëllim dhe kanë përgjegjësi të barabara për mbarëvajtjen e punë, njëri nga ato punon dhe shërben deri në detaj duke i plotësuar të gjitha



detyrimet e tij, ndërsa pjesëtari tjetër i grupit nuk është i përkushtuar aspak, për të tilla arsye si: papërgjegjshmëria dhe paaftësia e tij për atë lloj pune. Mbarëvajtja e punës do të vlerësohet në nivel grupi dhe jo në nivel individual dhe ajo për të cilën kontribuon vetëm njëri nga pjesëtarët e grupit shpërblehet njëlloj për të dy pjesëtarët. Këtu shtrohet pyetja: Sa është e drejtë kjo? Prandaj duhet që barazia të shikohet në dhënien e shanseve dhe mundësive të barabarta për të gjithë, por në garantimin e punës në bazë të vlerësimit që përkufizohet: bëj atë që di të bësh më mirë. Po të hedhim një vështrim në periudhat e kaluara, sidomos në periudhën e ushtrimit të skllavërisë do të vihet re një pabarazi e skajshme ose më saktë një personalizim i barazisë nga ai që ka në dorë pushtetin. Sistemi i kastave bazohet në një barazi të thellë, ku nëse një individ lind nga një familje e varfër ashtu do të vdesë dhe e kundërta. Në këtë sistem nuk i jepej asnjë mundësi një individ pjesëtar i kastës së ulët të ngjisë shkallët e hierarkisë, përveç femrave të bukura ku fati mund t'i çonte edhe në kastën më të lartë nëpërmjet martesave.

Ky lloj sistemi është një shembull tipik i mosdhënies së mundësive të barabarta për të gjithë dhe prandaj në ato kohë barazisë i vishej një tjetër kuptim. Megjithatë në kohën ku ne jetojmë është tjetërsuar sepse një individ mund të ngjisë shkallët e hierarkisë në bazë të meritave apo aftësive. Sot njeriu është i lirë plotësisht dhe e menaxhon këtë liri në mënyrë individuale, asnjë individ tjetër nuk ka të drejtën të ndërhyjë në vendimmarrjen e këtij personi deri në pikën ku nuk çenohet hapësira e tij e lirisë. Më kujton kjo shprehjen "Liria jote mbaron aty ku fillon liria e tjetrit". Le të shfrenojmë për një moment imagjinatën tonë dhe të mendojmë për një botë ku të gjithë janë të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe ku diversiteti nuk ekziston, të shohim pak se si dhe sa mund të funksionojë ky lloj sistemi dhe si do të ndryshonte sjellja e njerëzve në përshtatje të këtij sistemi. Duke iu referuar përvojës njerëzore, natyrës së njeriut si një qenie egoiste ky lloj sistemi do të përhapte një kaos të vërtetë. Por në kohën e sotme ngaqë ekziston diversiteti në barazi ka një emancipim dhe zhvillim të botës

njerëzore, përndryshe pse do të ishte e nevojshme ekzistenca e ligjeve, normave, rregullave dhe e vetë shtetit. Përkundrazi, meqë ekziston ky diversitet dhe kjo barazi në konceptin e dhënë më sipër janë të nevojshme të gjitha këto organe strukturore që të merren me hetimin dhe interpretimin e barazisë apo mosbarazisë. Këto shihen të nevojshme për të vendosur një bosht referimi sepse edhe kjo formë e barazisë të shpjeguar më lart dhe të praktikuar në ditët e sotme ka disavantazhet e veta dhe këto vijnë kryesisht në keqinterpretimin e kësaj forme të barazisë. Çuditërisht në skenat shoqërore shfaqen qenie të ndryshme individualiste që shkojnë tej në egoizëm duke e pranuar kurdoherë dhe e vlerësuar veten. Çdo person është vetvetja, ai s'është vetëm vetvetja, dhe në mendimet egoiste dhe mbivlerësuese të tij, ai është gjithçka. Në këtë kontekst, vërehen më pas kokëçarjet ndaj tjetrit, madje edhe në eliminimin e tjetrit. Kjo shkon më tej, kur dhe puna, që parimisht është një përpjekje për të ardhmen tonë dhe më pas të pasardhësve tanë, kthehet në diçka të kotë; njeriu mendon vetëm si të grumbullojë pasuri përmes parasë së fituar lehtë, ai nuk ka më as qejf të prodhojë por thjesht të qarkullojë paratë të fituar lehtë. Po sikur qenie të tilla të vijnë të vijnë e të shtohen gjithnjë e më shumë, si do të vendoset kjo e ashtuquajtur barazi në kontekstin e shpërndarjeve të fuqisë (duke iu referuar përkufizimeve që u



parashtruan gjatë këtij shkrimi) kaq e domosdoshme për të gjithë ne? Kjo pyetje nuk ka një definim të patundur sepse çdokush e sheh barazinë dhe shpërndarjen e saj në mënyra të ndryshme por një pseudopërgjigje mund të jepet, e tillë si kjo: Barazia dhe shpërndarja e saj duhet të bazohet te vlerat, aftësitë dhe potenciali që paraqet dhe shpreh një individ e jo në bazë të interesave, pushtetit, përfitimeve vetjake sepse është pjesë e të drejtës natyrore dhënia e shpërblimit në bazë të punës, mundit dhe lodhjes.

Shkroi: Izmina Zejnuni






PAS PROVIMEVE

Pas netëve të gjata pa gjumë nën steresin se si do të dalim në provimet e maturës shtetëore, fillon një etapë akoma më e vëshirë dhe vendimtare për të gjithë aspirantët për studentë, si të zgjedhim degën e duhur që përshtatet se shumë me dëshirat dhe aftësitë tona.

një periudhë meditimi dhe reflektimi mbi personalitetin tuaj. Duhet t'i bëni vetes një autoanalizë të thellë, por mbi të gjitha të sinqertë.

Cilat janë gjërat që më pëlqen të bëj? Cilat janë pasionet e mia? -Cilat janë gjërat që bëj më mirë dhe te të cilat kam



Ja disa këshilla, të cilat do t'ju ndihmojnë të bëni zgjedhjen e duhur.

Hapi i parë:

Pyetja e parë që duhet t'i bëjmë vetes është : Cilat janë ineteresat dhe aftësitë e mia?

Para se të vendosni për të zgjedhur, refelektoni: periudha para se të vendosni se cilën degë do të zgjidhni duhet të jetë

pasur sukses? -Cilat janë aftësitë e mia më të mira?

Hapi i dytë:

Të bësh një analizë të tillë, të plotë mbi veten, nuk është e lehtë. Për t'i lehtësuar gjërat na vjen në ndihmë eksperiencia e viteve të shkollës së gjimnazit. Dhe këtu i bëjmë vetes pyetjen: Cilat kanë qenë lëndët e preferuara gjatë

shkollës ? Në cilat lëndë kam marrë gjithmonë notën maksimale? Kam qenë më i prirur në lëndet shoqërore apo ato shkencore? Duke i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, do të ngushtojmë rrethin e alternativave dhe në këtë mënyrë do ta kemi më të lehtë për të zgjedhur rrugën e duhur.

Hapi i tretë:

Pas analizës që i bëjmë vetes kalojmë në një tjetër hap i cili është gjithashtu i rëndësishëm. Provojmë tani të vihem përballë disa prej profesioneve hipotetike: dhe pyetjet vazhdojnë.....në cilin profesion do të ndjehem vetvetja? Si mjek, gjithmonë në shërbim të të tjerëve edhe në orët e vona të natës ??? Si gjykatës, avokat, në shërbim të së drejtës??? Si drejtues??? Si psikolog, ekonomist apo informaticien ??? Këto janë disa nga profesionet, të cilat janë të njohura dhe të pëlqyera nga pjesa më e madhe e maturanëve. Por është mirë që të gjithë maturanët të marrin informacion të detajuar për profesionet e reja, të cilat kërkohen edhe nga tregu i punës. Nisur nga kjo gjë është mirë që të bëni një ballafaqim të preferencave që ju keni në zgjedhjen e profesionit dhe realitetit, dmth cilat janë ofertat e tregut për punë. Cilat janë profesionet më të kërkuara sot në tregun e punës dhe sigurisht më të paguarat.?




Kjo gjë do të na mundësojë të bëjmë një zgjedhje sa me afër realitetit. Të kemi një profesion që na sjell kënaqësi shpirtërore, por edhe të mira materiale, që na sigurojnë një jetesë më cilësore. Rrezja e zgjedhjeve do të ngushtohet akoma me shumë pas këtij ballafaqimi.

Hapi i katërt:

Së fundi duhet të vizitoni të gjitha univerisitetet në "Ditët e hapura" që ato organizojnë për të parë nga afër se çfarë ndodh. Për të mbledhur më shumë informacion. Mos neglizhoni asnjëherë edhe bisedat me prindërit tuaj ose persona të tjerë, të cilët kanë qenë të sukseshëm në zgjedhjen e profesionit të tyre.

Sociologe: Oriola Heta (Varosi)



E Tashmja - E Sotmja - E nesërmja përmes sfidave, përplasjeve dhe ngritjeve tona

Poeti i shquar anglez Milton thotë: “Mendja jote në vendin e vet dhe në vetvete mund ta bëjë parajsën ferr dhe ferrin parajsë”!

Vetëm për ty e sotme jetoj, e nuk të kujtoj ty o ditë e djeshme e kështu të humb të sotmen, se ti shkove e përfundove dhe rrezet e tua perënduan si ato të diellit. Nuk lotoj për ty e as nuk të ëndërroj, se ti më le dhe ike dhe nuk do të kthehesh më kurrë. Ty o ditë e nesërme, që gjendesh në botën e panjohur nuk të jetoj në ëndrra e as ta dhuroj veten në gjëra të paqarta, sepse ti nuk je asgjë pasi ende s’ke arritur e as je përmendur! Për ditën tënde o njeri, rezervo vepra në fjalorin e lumturisë. “Jetën më të mirë e jetuam kur durimin e kuptuam dhe sikur të kishte qenë durimi në formë njeriu do ta shikonit sa bujar do të ishte”.

Mos u mbush me hidhërim se pas kësaj jete vjen një tjetër e pas kësaj dite një tjetër.

Qetësohu se ekziston dita kur do të kënaqesh me drejtësinë që të jepet, nëse ta grabitën pasurinë këtu, do ta gjesh atje dhe nëse të shkelin e të shtypin këtu, do të të jepet e drejta jote atje, e kush u bë mizor këtu, atje do të jetë prej të dëshpëruarve.

“Loja në këtë botë nuk është kompletuar, patjetër duhet të ketë skenë tjetër dhe shfaqje tjetër, sepse në këtë botë shohim zullumqarë e të shtypur, e nuk gjejmë dot drejtësi. Këtu hasim në pushtues dhe të nënshtuar dhe nuk gjejmë dot revansh. Atëherë patjetër duhet të ekzistojë një botë tjetër, ku të mbizotërojë drejtësia për të gjithë”.

Mos u pikëllo nëse të godet një fatkeqësi, por kërko të të shtohet durimi.

o Kur gjëra të tilla të ndodhin në jetë mos u pikëllo, me urtësi pyet veten tënde:

o A do të kishte mundur të më godiste një e keqe më e madhe?!

Çdo gjë ndodh me caktimin e Zotit të Lartësuar dhe në caktimin e tij nuk ndërhyjnë askush, por ndoshta kuptimi i thënies së lartshënuar është se shqetësimi i tepërt shkakton humbje të përditshme dhe e shkatërron përfundimisht njeriun. Një sëmundje tjetër që shfaqet prej këtyre shkaqeve është dhe ulçera në stomak. Doktor Josef f. Montagno, njëkohësisht dhe autor i librit “Problemi i nervozizmit” thekson: “Njeriut nuk i shkakton ulçer ngrënia e ushqimeve, por brejtja që i bën atij pikëllimi, trishtimi... .”

Dëmet që shkaktojnë këto ndjenja negative

Trishtimi, ankthi, pikëllimi, mërzia, stresi shkaktojnë sëmundje të:

- Zemrës

- Rrisin trysninë e gjakut

- Shkaktojnë sëmundje të reumatizmës

- Sëmurin lukthin

- Këto ndjenja bëhen shkaktar të ftohjes

- Shqetësimi dhe gjendra tiroide

- Diabetikët dhe shqetësimi

Doktor Russel Cecil nga Instituti i Mjekëve në Universitetin e Cornel-it ka vendosur katër shkaqe që sjellin artritisin:

-Mosmarrëveshjet bashkshorëto
-Vështirësitë financiare dhe shqetësimi
-Vetmia dhe shqetësimi
-Mëria dhe mllëfi

“Ndjenjat jo të gëzueshme si shqetësimi dhe frika ndikojnë në shpërndarjen e kalciumit në organizëm dhe si rrjedhojë prishjen e dhëmbëve”. Duke vëzhguar me kujdes këto studime, rezultate dhe konstatime mjekësh e filozofësh, a nuk mendon se është më mirë që punët e tua t’i kryesh me qetësi?!

Dale Carnegie thotë: “Afrikanët dhe amerikanët që jetojnë në jug dhe kinezët, janë popujt e vetëm që rrallëherë i godet sëmundja e zemrës që shkaktohet nga shqetësimi sepse ata kryejnë punët me qetësi të madhe dhe pa nervozizëm e zemërim”.

Depresioni një rrugë drejt vuajtjes.

Gazeta El-Muslimun, në nr. 240 të vitit 1990 jepte një raport ku tregohet se në botë ekzistojnë më shumë se dyqind milionë njerëz që vuajnë nga depresioni. Depresioni ka kapluar tërë njerëzimin. Këtu nuk përjashtohen njerëzit e lindjes apo të perëndimit, as të varfrit as të pasurit, por kjo sëmundje i godet të gjithë, dhe në shumë raste përfundimi është

o Përgatite veten që ta pranosh atë dhe ta durosh...

o Pastaj me qetësi shpirtërore përmirësoje mendimin që ke.

Mos u trishto, se trishtimi ta dobëson fuqinë dhe të shkatërron trupin.

Doktor Alexis Canel, fituesi i çmimit Nobël për mjeksi thotë: “Biznesmenët që nuk dinë si t’i përballojnë shqetësimet, vdesin herët.”

Vetvrasja.

Vetëvrasja nuk njihet pozita apo shtete mirëpo frikësohet nga besimtarët. Disa statistika tregojnë se sot në botë numri i të sëmurëve me depresion arrin mbi dyqind milionë dhe se një ndër dhjetë persona në botë janë të prekur nga kjo sëmundje. Por rreziku i kësaj sëmundje është se ajo nuk prek vetëm të rritur e të moshuar, por edhe fëmijën në barkun e nënës.

Depresioni një rrugë drejt vetvrasjes.

Në Kur'anin Fisnik thuhet:

“Dhe mos e mbytni veten tuaj”

“Dhe mos e hidhni veten në rrezik”

Sipas raporteve mjeksore të botuara në Amerikë ish presidenti i SHBA, Ronald Regan ishte viktimë e vuatjes nga depresioni. Ai edhe në moshën shtatëdhjetë vjeçare ka pasur depression dhe tension të lartë me gjithë operacionet e bëra. Po ashtu edhe Napoleon Bonaparti ishte në depression të thellë para vdekjes.

Janë të shumta rastet ku depresioni i njeriut rezulton edhe në dëm të të tjerëve. Shembulli I nënës gjermane e cila vrau tre fëmijët e saj, ngaqë ishte depresive dhe duke dashur t'i “rehatojë” ata nga dhimbjet dhe përgjegjësia që kishte për ta, ajo i vrau të tre dhe në fund vrau veten.

“OBSH” tregon rrezikun nga kjo sëmundje. Në vitin 1973 të sëmurët me depresion ishin vetëm 3 % dhe në 1978 u rrit me 5% ku thuhet se një në çdo dy njerëz në Amerikë vuante nga depresioni. Ndërsa të dhëna të tjera tregojnë se në botë nga kjo sëmundje vuajnë më shumë se dyqind milionë njerëz.

Kuptoje se nëse nuk mund ta bësh dicka, kapërceje dhe bëj atë që mundesh. Njerëzit shpesh thonë: “Mos e bluaj miellin”. Pra çështjet që i kenë mbyllur janë kalimtare nuk duhet të përsëriten, sepse aty krijohet mërzia, dëshpërimi dhe humbjet.

Puno me qetësi dhe largo pasivitetin.

Puno me qetësi dhe largo pasivitetin nga vetja që të shmangësh të menduarit negativ. Mjekët këshillojnë si kurë kundër këtij fenomeni punën.

Doktor Richard Cabot, Profesor i mjeksisë në universitetin e Harvard-it në librin e tij të titulluar “Me çfarë jeton

njeriu” thekson: “Unë si mjek ju këshilloj -punën- si ilaçin më të suksesshëm për të sëmurët që ankohen nga krizat nervore, si rezultat i dyshimeve, luhatjeve dhe frikës. Pra, puna për ne është ajo që na dhuron trimërinë, na bën të bazohemi në vetvete”.

“E kur të fryhet falja, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e Allahut”.

Thomas Edison thotë: “Nuk ekziston mjet që njeriu të ikë nga mendimet e tij”.

Kjo fjali është vërtetuar edhe në praktikë. Ndodh që njeriu të shkruajë apo të lexojë dhe ai përsëri mendon. Ajo që e edukon mendjen dhe e lë të stabilizuar është serioziteti në punë, i cili të jep fryte të dobishme.

Një nga dijetarët e mëdhenj të botës Islame ka treguar: “U sëmura njëherë dhe mjeku më tha se leximi dhe mbajtja e bisedave mbi çështje akademike do ta përkeqësonte gjendjen time. I thashë se nuk mund t'i braktisja ato gjëra dhe se do të doja që nëse më lejonte të bëja gjykatës dijen e tij.

A nuk është e vërtetë, e pyeta, që nëse shpirti ndihet i lumtur dhe i gëzuar, trupi bëhet më i fortë dhe sëmundja largohet ?!!
Doktori pohoi.

Atëherë thashë:- trupi im gjen gëzim në dije, sistemi im imunitar forcohet dhe unë ndiej rehati. Doktori pranoi dhe tha se kjo ishte jashtë kufinjve të mjeksisë së tij”.

I mençuri humbjet i shndërron në fitore, kurse injoranti frikacak një fatkeqësi mbi kokën e tij e rrit dhe e dyfishon.

Kur të dërguarin e Zotit Muhamedin a.s e dëbuan prej Mekës në Medine ai themeloi atje shtetin e ri që shëndriti dhe për të foli historia.

Nëse mbi ty bien re të zeza, bindu se nga njëra anë e tyre do të shkëlqejë drita. Nëse dikush të jep lëngun e thartë të

limonit shtoji sheqerin, e nëse dikush të jep si dhuratë gjarprin, mos e refozo, pranoje dhe shfrytëzoja lëkurën.

Pra në momentet më të vështira mos u përhum, por jetoji ato në mënyrën më të mirë, mos e ndërprit aktivitetin tënd, se nga kjo kohë do të mund të mbjellësh trëndafilat dhe jaseminë me aromë të këndëshme.

“Erdhi caktimi i Zotit, pra mos kërkoni ngritjen e tij”.

Mos vepro para kohe. A dëshiron t'a nxjerrësh foshnjën para plotësimin të muajve, e ta këpusësh frutin ende pa u pjekur?! Është marrëzi ta tresësh mendjen atje ku nuk ke punë, e nesërmja ishte e humbur dhe e fshehur, ti s'e di se si të vjen e ç'të sjell me vete.

Ndoshta largohesh nga kjo botë që sot, para se të vijë e nesërmja, apo mos kujton se e kalove urën pa shkelur mbi të -kush e di?! Ndoshta këmbët na këputen para se të arrijmë te ura, apo ura rrezohet para se të mbërrijmë ne, ose ndodh edhe të kalohet ajo pa asnjë problem.

Të lodhësh trurin me mendime për të ardhmen dhe të orvatesh ta hapësh librin e së panjohurës e të tregohen ndodhurat është diçka e papëlqyer që sjell shqetësime të panevojshme, sepse shumica e njerëzve në këtë botë përfytyrojnë se në të ardhmen do të mbeten të uritur, të sëmurë, të varfër, gjë që nuk ekziston në botën e tyre të panjohur, por është vetëm pëshpëritje e djallit.

“Djali ju frikëson me varfëri e ju urdhëron për të këqija, por Allahu ju garanton falje

e begati”.

Ka shumë njerëz, të cilët besimi i dobët i shtyn të qahen se do të jenë të uritur e të sëmurë pas një viti. Jeta jote dhe furnizimi yt nuk janë në dorën e njeriut që të mbetesh në udhëkryq, ndaj mos e zhyt veten në mëkate, sepse ti nuk e di se si do të jetë fati yt.



Mos shko shumë larg, vetëm përkujto kur nëna rrit një fëmijë, ajo e ushqen e veshmbath, e edukon e mëson dhe natën e kalon pa gjumë që fëmija të flerë. Ajo rri vetë e uritur që ai të ngopet, lodhet që ai të pushojë. E kur ky fëmijë rritet e bëhet i fortë i kthen shpinën nënës, harron lodhjet e saj, shkel mundin dhe mohon kujdesin e saj. Ndaj nëse dikush t'i humb vlerat e mirësisë tënde, mos u trishto se



ato do t'i glesh tek Ai që nuk humbet asgjë sado e vogël të jetë. Vepro mirë për të tjerët vetëm për hir të Zotit tend, se në cilëndo anë që të kthehesh je fitues. Falenderoje Atë që je bamirës-e, e jo i dëmshëm për të tjerët, se dora që jep është më e mirë se ajo që merr. Njeriu kalon nëpër tre etapa: -Imitimi; -Përzgjedhja; -Shpikja -Krijueshmëria. Imitimi, akti i të kopjuarit të personalitetit dhe sjelljes së një personi


tjetër, kryhet për shkak të pëlqimit të madh të personit të imituar ose për shkak të animit të madh drejt tij. Kur shkohet në skajet e të imituarit deri tek toni i zërit dhe gjesteve trupore, personi imitues në fakt është duke varrosur personalitetin e vet. Kjo mund t'u duket absurde disave, por hidhini një sy brezit të ri. Do të shihni disa prej tyre të imitojnë njerëzit e famshëm në mënyrën e ecjes, të folurit dhe veprimeve. Tërë veçantitë e tyre i

braktisin për hir të kopjimit të idhujve të tyre. Po të imitonin tipare fisnike dhe personalitete të ngritura, do të ishte diçka e lavdëruar, sepse imitimi i dikujt në kërkimin e dijes, në bujarinë e në mirësjellje është në vetvete një akt fisnik. Ti, krijesë e lartë, je një entitet unik dhe qëkur Zoti krijoi Ademin nuk mund t'i glesh dy njerëz njësoj. Përse atëherë kërkujmë të jemi si të tjerët në tipare dhe aftësi?!

Bukuria e zërit tënd është në unikalitetin tënd dhe bukuria e pamjes tënde, është e veçantë dhe veçori vetëm e jotja!



Përmbodhi dhe përshtati: Edlira Durmishaj





TROKAS

Çanta e Udhëtimit



Është kohë pushimesh dhe ndoshta e vetmja gjë që na shkon nëndërmend të përgatisim është një çantë. Jo për të vajtur në punë, por për t'ia mbathur diku gjetkë, larg prej monotonisë që të kaplon kryesisht në ditët e nxehta.

Mirëpo jo tërësisht në këtë sens, në na duhet të bëhemi gati !

Çfarë keni përgatitur në këtë çantë udhëtarët e mi të dashur ?

A ke bërë gati dhe ke palosur në të rrobën e devotshmërisë dhe veshjen e frikës e të turpmit nga Zoti i Lartësuar. Apo ke përgatitur dhe vendosur veshjet e modës dhe je larguar paksa nga Zoti i Qiellit dhe i Tokës?

A i ke përgatitur mirë gjërat për atë gropë të errët e të humbur, të ngushtë e të lagësht në të cilën do të banosh i vetëm, i harruar e në errësi poshtë dheut ?

A ke menduar se çfarë të pret në të ?- A je menduar ndonjëherë se çfarë do të duhet të bësh për të shpëtuar nga errësira dhe nga ngushtica e tij ?

A je shqetësuar ndonjëherë për këtë shpërngulje të largët dhe për këtë udhëtim të gjatë, çfarë do të thuash kur ti të jesh i shtrirë dhe të anosh nga një anë e shpatullave e sytë të ndalojnë në errësi. A do të dëgjojnë ulërimën tënde duke thërritur : Ej ku po më shtyni kështu ? Ku po më çoni mua? Apo do të thuash më shpejt më nxirrni mua ! Unë të jem i pari ! A je merakosur ndonjëherë për këtë shpërngulje të largët dhe për këtë udhëtim të gjatë, çfarë do të thuash kur ti të jesh i vetëm pa familje, miq e shokë ...

A je merakosur ndonjëherë se a do të jesh prej atyre që do mund të thonë në atë moment: "Allahu i forcon ata që besuan në fjalën e fortë, në jetën e kësaj bote



edhe në botën tjetër, ndërsa mizorët Allahu i bën të humbur . Allahu punon çfarë të dojë."

Apo merakosja për ju mos ka qënë të kaloni jetën dhe kohën duke vështruar në gjëra të ndaluara, apo duke dëgjuar këngët, të cilat Zoti nuk kënaqet me to, apo duke parë filma, telenovela, që nuk përfiton asnjë gjë prej tyre dhe kur vjen koha e namazeve i shpejton ato, apo ulesh në ambiente ku diskutohen dhe dëgjoen çështje të papëlqyera dhe kështu largohesh nga Zoti i Qiellit dhe i Tokës?

Udhëtarë të dashur,

Kush ia shton vetvetes devotshmërinë, veçse ka fituar dhe është i lumtur dhe kush i shton vetvetes gjynahet veçse ka humbur, sepse kush ndjek rrugën e shejtanit do të jetë fatkeq dhe i mjerë dhe kush kërkon kënaqësinë e Allahut, do të jetë prej të dashurve të Mëshiruesit siç edhe përmendet në Kuran:

"Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut nuk kanë frikë në botën tjetër e as kurrfarë brengosje."

Atëherë ejani të mbushim këtë çantë me çdo gjë që na duhet ta kemi me vete për këtë udhëtim dhe të udhëtojmë së bashku me begatinë e Zotit dhe le të kalojmë në pikën tjetër që përmban kjo pasaportë për të njohur se për ku do të na çojë fati dhe e ardhmja jonë.

Autor: Sejid Bin AbdulaAziz ElSaedani
Përktheu : Ermira Muça





PËRSE E DUAM KURANIN?

Zoti i lartësuar na ka begatuar me shumë gjëra, me aq shumë saqë nuk mundemi t'i numërojmë të mirat e Zotit tonë. Por begatia më e madhe është zbritja e Kuranit tek ne me të cilin udhëzohemi dhe ndriçohemi drejt lumturisë në dynja dhe ahiret, sepse Kurani në të vërtetë ka zbritur për lumturinë e njerëzimit.

Zoti i Madhëruar thotë në Kuran: "Ky është libër udhëzues për të devotshmit." Surja Bekare.

Profeti alejhi selam, shpeshherë për butësinë që kishte e mirësinë, Aishja thoshte për të, është si Kurani që ecën në tokë sikurse ne".

Por si mund të bëhemi të devotshëm e si mund ta duam vërtet Kuranin?

Për tu bërë të devotshëm, duhet të pastrojmë zemrat tona nga gjynahet, mëkatet, meritë e hatërmbetjet që kanë pllakosur e mpleksur si ndryshku. A mundet që vetëm uji të mund ta lajë atë? Sigurisht që ky ndryshk nuk ikën veçse me ujë, por kërkon përpjekje për të ushtruar forcë e dëshirë për ta pastruar.

Sigurisht pamja e mirë e zemrës dhe e trupit kënaq sytë, ashtu sikurse meloditë kënaq veshin, ndërsa pastrimi i vërtetë i zemrës arrihet me përmendjen e Allahut dhe me leximin e Kuranit.

Profeti alejhi selam ka thënë: "Kush lexon një shkronjë nga libri i Allahut do të ketë shpërblim e shpërblimi do të dhjetëfishohet dhe unë nuk them se elif-lam- është një shkronjë, por elif është një shkronjë dhe lam- është një shkronjë - e

cila shpërblehet me 30 sevape apo punë të mira."

Ju duhet ta dini mirë se për çdo gjynah që bëjmë na vendoset një pikë e zezë në zemrat tona.

Në Kuran thuhet: "Punët e mira i fshijnë ato të këqijat." Pra me 3 shkronja arrijmë të fitojmë 30 shpërblime dhe pastrojmë zemrën tonë nga 30 gjynahe.

A nuk është kjo një mrekulli e Kuranit dhe le të mendojmë më pas se çfarë pastrimi i bën zemrës leximi i të gjithë Kuranit dhe leximi shpesh i tij.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: "O ju që keni besuar, ju është bërë obligim agjërimi ashtu sikurse atyre para jush që të bëheni të devotshëm".183- Bekare.

Pra Kurani dhe agjërimi sjellin devotshmëri. Në ajetin 185 tek Surja Bekare: Muaji i Ramazanit është ai në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues i së mirës nga e keqja. Pra kushdo nga ju që e arrin këtë muaj, le të agjërojë".


Pra Allahu i Madhëruar urdhëron të agjërohet ky muaj, ky muaj i Kuranit.

Suksesi i këtij adhurimi realizohet vetëm atëherë kur plotësohen dy elementë kryesorë, njëri fizik dhe tjetri shpirtëror. I pari ka të bëjë me heqjen dorë nga ushqimi dhe epshet fizike. I dyti ka të bëjë me ruajtjen nga gjynahet. Këto elementë janë më të domosdoshmit për të përfituar nga udhëzimi hyjnor. Pra Kurani nuk mund të besohet drejt, nuk mund të besohet thellë dhe të mbartet për tu



zbatuar nëse barku është i tejmbushur me ushqim, sepse edhe vetë truri nuk funksionon në rregull dhe nëse shpirti është i ngarkuar me mëkate, sepse nuk lejojnë që drita e Allahut të reflektojë ashtu siç duhet në pasqyrën e shpirtit. Ajo çfarë e përforcon më tepër atë që u tha më lart është se profeti i Zotit këshillon më së shumti gjatë Ramazanit, leximin e Kuranit. Aishja, bashkëshortja e profetit tregon se profeti në Ramazanin e tij të fundit e ka përsëritur Kuranin dy herë. Edhe shokët e profetit e kanë lexuar shumë Kuranin gjatë agjërimit ato e kanë shtuar leximin dhe përkushtimin ndaj tij për shkak se përqëndrimi i mendjes dhe e

shpirtit janë më të orientuar ndaj Kuranit më shumë se kurdoherë tjetër, sepse trupi është më i lirë po ashtu edhe shpirti. Kurani ka vlerë mbi çdo fjalë tjetër, ashtu siç ka shumë e më shumë vlerë Zoti i Lartësuar mbi të gjitha krijesat e Tij. Leximi i Kuranit, është vepra më e mirë me të cilën njeriu mund ta kalojë kohën dhe ta mbushë atë me mirësi. Nuk duhet harruar të themi se Kurani është ndërmjetësues i lexuesit të tij në ditën e Gjykimit. Profeti i Zotit thotë: "Lexojeni Kuranin sepse ai do të vijë ndërmjetësues për ju, pra për lexuesin e tij në ditën e Gjykimit."



Qendra Social- Kulture e Mawaddah we Rrahmah ka mundur të ofrojë aktivitete të shumta në çdo aspekt social jetik, kulturor e shkencor përgjatë eksperiencës së saj në fushën e Thirrjes Islame, përmes Institutit të Gjuhës dhe Shkencave Islame, përmes mësimëve të shumta në konviktin studentor, shërbimeve sociale, workshopeve, trajnimve, semianreve e simpoziume me një ritëm aktiv, konkret sinkronizuar me sfidat e kohës dhe kërkesat e një shoqërie që rend me hapa galopantë teknologjie, promovimi e prosperiteti. Muaj pas muaji Departamentet pranë kësaj Qendre me fokuset e tyre në aspekte nefralgjike sa i përket fushës së të mësuarit e të nxënies, edukimit dhe etikës, kulturës dhe ofrimit të shërbimit dhe përkujdesjes sociale kanë shënuar arritje suksesi, kanë kurorëzuar aktivitete të konceptuara shkencërisht e kulturalisht mirë. Departamenti i Kurikulave dhe Programeve mesimore ka patur një axhendë të tejmbushur me mësimet e Gjuhës Arabe, mësimet-hyrëse të leximit të Kuranit me grupe të ndryshme bazuar në nivel kompetencash dhe me kategori të ndryshme studentesh, grash dhe vajzash të reja.

Departamenti i Thirrjes Islame po ashtu ka ndjekur një linjë të gjithëhershme në fushën e mësimdhënies, atë me studentë pranë konviktit studentor por edhe me mësimet që organizohen pranë xhamisë Dine Hoxha me një pjesëmarrje të gjerë të grave dhe vajzave besimtare.

Departamenti i Studenteve është prej Departamenteve ku puna, angazhimi,

përkujdesja maksimale, përkushtimi sjell veçse rezultate të mira me studentet e konviktit. Mësimet me tematika të larmishme, aktivitete sociale- kulturore, seminare në nivel universitar që kanë realizuar vetë studentet, ekskursionet dhe workshope të tjera kreative kanë bërë që çdo ditë pranë Qendrës të ofrojë mësimdhënie të kulturor e bashkekohore, qytetari, kreativitet në fushën e edukimit të vlerave njerëzore.

Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë. Siç edhe emri e tregon ka mundësuar mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me donatorë, vizitorë të shumtë e dashamirës të Qendres, bordit drejtues e stafit. Përveç kësaj ka mundësuar përkthimin e çdo aktiviteti të realizuar këtu në vendin tonë dhe gjuhën tonë të jetë i lexueshëm në gjuhën e donatorëve përmes një pune cilësore.

Departamenti i Jetimëve - jetimët janë porosia që na e la profeti i Zotit për përkujdesje ndaj tyre, për përkëdhelje , përkujdesje e mirësi për ta.

Ky departament ofron mësimet, aktivitete me fëmijë jetimë dhe nënat e tyre. Ka organizuar si rrallë herë e realizojnë organizata të tjera simotra, - vizitën dhe mbajtjen e lidhjeve me shtëpitë e jetimëve, për tu njohur më nga afër me to, me jetesën e tyre, problemet e mangësitë. Departamenti i Financës hap pas hapi duke dashur të qëndrojë korrekt me paketën ligjore që rregullon marrëdhënien punëmarrës- punëdhënies, e marrëdhënieve mes palësh me të tretët ka treguar marrëdhënie etike me të gjithë departamentet sa i përket sjelljes etike mbi pagat, sigurimet, kushtet e punës, dokumentacionet mbi detyrat dhe të drejtat etj.

DEPARTAMENTI I BOTIMEVE

Përveç daljes së revistës "Përtej Fjalës" tashmë në format online, përgatitjes tematikore, përzgjedhjes së materialeve, gazetarëve etj, ky departament ka organizuar tre simpoziume me intelektualë respektivisht përgjatë tre muajve si:

Prill 2015- Maj 2015 dhe Qershor 2015 , me tematika të ndryshme dhe me një pjesëmarrje dinjitoze të grave dhe vajzave intelektuale dhe studentesh nga fakultete të ndryshme.

SIMPOZIUM 30 PRILL 2015

Simpoziumi" INTELEKTUALET DHE MEDIA : qasjet aktuale ndaj saj fton studiues të diskutojnë së bashku rreth çështjeve në fjalë.

Fjala përshëndetëse nga Drejtoresha e Qendrës : Msc: Shpresa Basha
Trajtesat u përqëndruan në këto terma:

- Media Vizive dhe pushteti i saj në orientimin e audiencës. Dr. Belina Budini - Universiteti European i Tiranës
- Media, lajmi në terren dhe kronika - nga Anila Hoxha, gazetare Departamenti i informacionit - Kronika Top Channel
- Media dhe ndikimet e saj tek zgjedhjet fëmimore - Psikologe klinike Dr.Anjeza Dishnica
- Media e shkruar dhe të dy anët e mediales - nga Albana Muja, Specialiste e Gjuhës dhe Civilizimti francez- publiciste



SIMPOZIUM 30 MAJ 2015

Intelektualet , gruaja në vendim/marrje

Tema : "Puna në këndvështrimin islam, a është puna adhurim dhe investim apo....."

Nr.	Emri Mbiemri	Institucioni- angazhimi	Tema	Min
o	Albana Muja	Përgjegjëse e Dept. të Botimeve - Meudah ue Rrahmah	Fjala hyrëse / mirëseardhjes	5
1.	Dr. Suela bala	Drejtoresha e Institutit Shqiptar të Marrdhënieve Publike - Tr- Shqipëri	Studime mbi çështje sociale të punësimit të gruas	20
2.	Msc. Fabjola Ajdini	Menaxhere Njesie / Divizioni. Sherbim klienti prane Albtelecom, Tr- Shqipëri	Realitete të punësimit pranë kompanive të huaja, çështje të grave -leader në sipërmarrje	20
3.	Msc. Ilda Kanapari	Përgj- admin Instituti i Përkujdesjes për të Moshuar, Kavajë- Shqipëri	Puna në këndvështrime krahasuese në islam	20
4.	Interviste me Drejtorin e Radio 1, Gazmend Leçini , gazetar		Radio e parë islame ne Shqipëri: programi, dëgjueshmeria , përgjegjshmëria para dëgjuesve, etika dhe profesionalizmi.	10
5.	Interviste me përgj, e Departamentit të Gruas pranë KMSH		Puna dhe gruaja në islam	10
6.	Intervistë me Ornela Bitar-Orbita -Design & Printing - Intervistë me drejtoreshën e Kopshtit "Lodrojmë",Msc. Adelina Kasemi. - Intervistë me Phd.Erjona Xhaferraj, admin. e " Sekretet e Natyrës" - Intervistë me admin.e Butik Belisa- Besiana Struçe		Puna e ngritur me profesionalizëm, përpjekje e përkushtim prej grave besimtare, arritjet e tyre, ofertat dhe kërkesat në tregun dhe shoqërinë ku operojmë, si përtjerje e imazhit të gabuar që krijohet jo rrallë ndaj grave në islam. Puna e ngritur nga nje dorë, ide dhe finesë gruaje, me shijet dhe tendencat më të fundit të stilit orientat të veshjeve	



SIMPOZIUM 30 QERSHOR 2015

Qendra Social-Kulturore "MEWADAH WE RAHMAH organizon ditën e MARTË, më dt.30.06.2015, ora 18⁰⁰- 20⁰⁰

SIMPOZIUMIN ME TEMË: "DILEMAT E NJË MATURANTI - STUDENTI"

Nr.	Emri Mbiemri	Institucioni- angazhimi	Tema	Min
o	Albana Muja	Përgjegjëse e Dept. të Botimeve - Meudah ue Rrahmah	<i>Fjala hyrëse / mirëseardhjes</i>	5
1.	Dr. JULIANA AJDINI	PEDAGOGE - Pranë Fakultetit të Shkencave Sociale - Universiteti i Tiranës	<i>Zgjedhjet parësore të maturantëve pranë Universiteteve Publike- Rëndësia dhe besueshmëria</i>	20
2.	Dr. ANJEZA XHAFERRAJ	AS/ PEDAGOGE- pranë Universitetit European të Tiranës	<i>Universiteti privat dhe fleksibiliteti në zgjedhje të degëve dhe profileve</i>	20
3.	Msc. ENTELA HIDRI	Mësuese pranë Shkollës Jopublike- H.IBRAHIM DALIU - TIRANË	<i>Orientimi drejt prirjeve kryesore te nxënësve, maturantëve sipas sistemit ndërkurrikular</i>	20
4.	Qendrimet personale nga maturantët/ studentët		<i>Opinione nga salla</i>	10
5.	Pyetje-përgjigje	Pyetje nga studente të shumta ne sallë, qëndrime, opinione, emocione etj		10
6.	Honor - Iftar me intelektuale Duaja e iftarit : Zoti im, për Ty agjërova, dhe me rriskun tënd po çel iftarin. Uria u shua, venat u njomën dhe u arrit shpërblimi inshaAllah. Amin !	-	<i>Në ambientet e Qendrës- Kati i 1</i>	

Ky ishte aktiviteti përmbyllës i këtij sezoni ose viti akademik 2014-2015, me shpresën për të qenë sërish me ju në seminare, simpoziume dhe aktivitete të këtij lloji me qëllim përmirësimin tonë dhe orientimin drejt qasjeve etike frytdhënëse përkundrejt sfidave dhe problematikave me të cilat përballet e tashmja dhe e ardhmja jonë.

Me shpresën tek Zoti kthehemi në Shtator 2015 me risitë që do të sjellë viti i ri shkollor jo vetëm për femijët, nxënësit dhe studentët, por për të gjithë ne.

Kryeredaktorja



Mundeson:

Qendra Social- Kulturore



“Mawaddah we Rrahmah”

